

10688

Republika e Shqiperise
Gjykata e rrethit
Nr. 10688/Akti

Tirane, me...C .1995

V E N D I M
PER REGJISTRIMIN PERSON JURIDIK

Ne Tirane, sot me daten 9.05.1995 une gjyqtarja Luizë Cafa, ne gjykaten e rrethit Tirane, mbasi shqyrtova kerkesen per regjistrimin person juridik te kerkuesit Skender Leka, administrator dhe

KONSTATOVA SE:

Kerkuesi, Skender Leka, ne cilesine e perfaqesuesit te pales shqiptare sipas autorizimit perkates dhe ne zbatim te n.7 te Kontrates se Themelimit, administrator deri ne regjistrimin e shoqerise se re italo-shqiptare te emertuar "ITALB MERMERI-UP-MUHUR" Sh.p.k. me kapital themeltar 50.000.000 leke (pesedhjete milion leke), te ndare ne raportet 75% ortaku italian dhe 25% ortaku shqiptar, me kohezgjatje 50 vjet, me seli ne Muhur-Peshkopi, kerkon regjistrimin e shoqerise person juridik per te ushtruar aktivitetin e meposhtem:

A. Nxjerrjen, perpunimin, transformimin, komercializimin dhe eksportimin e mermereve, gureve ornamental, materialeve te ndertimit te vendit dhe nen-produkteve te tyre.

B. Importimin ne Shqiperi te cdo lloj mermeri, gureve dekorativ dhe nen-produkteve te tyre per perpunimin, transformimin, tregtimin dhe eksportimin eventual.

C. Prodhimin, tregtimin, importimin dhe eksportimin e materialeve te ndertimit.

D. Zhvillimin e aktiviteve industriale, tregtare, financiare dhe ndertimi qe do te konsiderohen nga Asambleja e Ortakeve te leverdisshme dhe ne perputhje me objektin e shoqerise.

Per ushtrimin e ketij aktiviteti kane plotesuar te gjitha kushtet e kerkuara nga ligji, kane nenshkruar regullisht Kontraten e Themelimit, Statutin e shoqerise dhe aktet e tjera.

Kjo kerkese eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Bazuar ne Ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", ne Ligjin Nr. 7667, date 28.01.1993 dhe ne Ligjit Nr. 7764, date 2.11.1993

V E N D O S A :

Te pranoj kerkesen per regjistrimin person juridik te kerkuesit Skender Leka, per regjistrimin ne regjistrin tregtar te shoqerise se perbashket italo-shqiptare te emertuar "ITALB MERMERI-UP-MUHUR" Sh.p.k., me kapital themeltar

50.000.000 leke (pesedhjetë milion) ,te ndare ne raportet 75% ortaku italian dhe 25% ortaku shqiptar, me seli ne adresen; Muhur-Peshkopi, me kohezgjatje 50 vjet, me administrator deri ne daten e regjistrimit, z. Skender Leka, me objekt

A. Nxjerrjen, perpunimin, transformimin, komercializimin dhe eksportimin e mermereve, gureve ornamental, materialeve te ndertimit te vendit dhe nenprodukteve te tyre.

B. Importimin ne Shqiperi te cdo lloj mermeri, gureve dekorativ dhe nenprodukteve te tyre per perpunimin, transformimin, tregtimin dhe eksportimin eventual.

C. Prodhimin, tregtimin, importimin dhe eksportimin e materialeve te ndertimit.

D. Zhvillimin e aktiviteteve industriale, tregtare, financiare dhe ndertimi qe do te konsiderohen nga Asambleja e Ortakeve te leverdisshme dhe ne perputhje me objektin e shoqerise.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne gjykatën e Apelit.

Gjyqtare

Sh. Le. Cepo
Off

KONTRATE THEMELIMI

ITALB MERMERI-UP-MUHUR SHPK



1. Miniera e Mermerit ne Muhur ,person juridik shqiptar me qender ne Muhur-Peshkopi(Shqiperi)e perfaqesuar nga Drejtori i saj ,z.Skender Leka ,pajisur reregullisht me autorizim te leshuar nga Keshilli i Rrethit Diber i noterizuar me aktin nr.3185, date 26.7.1994 qe i bashkelidhet ketij akti (Lidhja 1) dhe,

2. Shoqeria UP&UP Shpk. person juridik italian, me qender ne Massa, Rr. Acqua-le 3-Itali, perfaqesuar nga administratori i vetem i saj, z. Baldini Giuseppe, i pajisur reregullisht me autorizim leshuar nga Asambleja e Ortakeve, i noterizuar me aktin date 20.1.1995. qe i bashkelidhet ketij akti (Lidhja 2).

Bien dakort te hartojne kontraten qe vijon per themelimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, e cila eshte vazhdim i Ndermarrjes se perbashket UPEM-Muhur, miratuar nga Keshilli i Ministrave me vendim nr.251, date 2.08.1991.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar qe krijohet ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dhe vecanerisht, por jo eskuzivisht, me ligjin Nr.7764, date 2.11.1993 "Per investimet e huaja", ligjin Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", etj, ligjeve qe do te dalin gjate kohes se veprimtarise se shoqerise si dhe dispozitat e statutit te shoqerise qe eshte pjese perberese e kesaj kontrate dhe qe i bashkelidhet (Lidhja 3).

Neni 1

Emertimi i shoqerise eshte ITALB MERMERI -UP-MUHUR Sh.p.k.

Neni 2

Selia e shoqerise eshte caktuar ne Muhur -Peshkopi, Republika e Shqiperise.

Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise do te jete 50 (pesedhjete) vjet nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te gjykates se Tiranes.

Neni 4

Shoqeria fiton te drejten e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te gjykates se Tiranes.



Neni 5

Objekti i shoqerise eshte :

A.. Nxjerja,perpunimi,transformimi,komercializimi dhe eksportimi i mermereve, gureve ornamentale, materialeve te ndertimit te vendit dhe nenprodukteve te tyre.

B. Importimin ne Shqiperi te cdo lloj mermeri,gureve dekorative dhe nenprodukteve te tyre per perpunimin,transformim,tregtim dhe eksportimin eventual.

C. Prodhimin,tregtimin,importimin dhe eksportimin e materialeve te ndertimit.

D. Zhvillimin e aktiviteteve industriale,tregtare,financiare dhe ndertimi qe do konsiderohen nga Asambleja e Ortakeve te leverdisshme dhe ne perputhje me objektin e shoqerise.

Neni 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 50.000.000(pesedhjetë milion) leke dhe perbehet nga kontributet ne natyre dhe para te ortakeve.

Kontributi i ortakut shqiptar eshte prej 12.500.000(dymbëdhjetë milion e peseqind mije) lek i gjithë ne natyre.

Kontributi i ortakut italian eshte 37.500.000(tridhjetë e shtatë milion e peseqind mije) leke.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 5000(pesemije) pjese (kuota) teresisht te firmosura e te shlyera ,me vlere 10000(dhjetë mije) leke sejcila te renditura sipas numrit te serise nga nje ne pese mije:

Ne baze te kontributeve te lartepemendura,ortakut shqiptar i takojne 1250 pjese te kapitalit themeltar te renditura nga numri nje i serise deri ne numrin 1250 te barabarta me 25% (njetë e pese perqind) te kapitalit themeltar. Ortakut italian i takojne 3750 pjese te kapitalit themeltar,nga numri 1250 deri te numri 5000 i serise,te barabarta me 75% (shtatëdhjetë e pese perqind) te kapitalit themeltar.

A.. Kontributet e ortakut shqiptar ne natyre perbehen :

A..1-Nga e drejta e perdorimit per 50(pesedhjetë) vjet, vec zgjatjeve apo shkurtimeve eventuale, te vendburimeve te mermerit e gureve dekorative te Minieres se Mermerit ne Muhur(MMM) dhe gjithë territorit perreth qe i takojne minieres sipas planimetrise aprovuar qe i bashkelidhet kontrates si pjese perberese e saj(lidhja 4).

A..2-Nga pronesia e ngrehinave te ndryshme,makinerive,impjanteve,pajisjet dhe automjetet ekzistuese ne gjendje pune,mallra ne magazine perfshire dhe blloqe mermeri,te gjitha prone te MMM,sipas inventarit bashkelidhur.(Lidhja 5)



B. Kontributet e ortakut italian ne natyre e para perbehen:

B.1-Nga kontributi ne para prej 1.616.000(nje milion e gjashteqind e gjashtembedhjete mije) leke, derdhur nga UP&UP Srl ne arken e UPEM-Muhur.

B.2-Nga know-how, dekontacioni teknik dhe gjithë konsulenca teknike e nevojshme per kerkimin dhe shfrytezimin e vendburimeve, transformimin dhe komercializimin e prodhimeve dhe pergatitjen e praktikave profesionale te personelit te shoqerise prane stabilimenteve italiane, kontribut qe konveksionalisht dhe definitivisht vleresohet ne 10 % (dhjete perqind) te kontributeve te UP&UP ne natyre.

B.3-Nga makinerit , pajisjet e materialet e nevojshme per mekanizimin e punes dhe futjen e teknologjive te reja per shfrytezimin dhe perpunimin e materialeve, sipas listes bashkelidhur (Lidhja 6).

Te gjitha kontributet ne natyre te ortakut italian, me vlefte 35.884.000 leke jane vleresuar sipas nenit 42, te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 nga nje ekspert i caktuar me marreveshje midis ortakeve , caktuar ne marreveshje midis ortakeve , me aktin Nr. 7 qe bashkelidhet si pjese perberese e ketij akti.

Kontributet ne natyre te ortakut shqiptar jane vleresuar sipas vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 47, date 7.02.1994

Te gjitha kontributet ne natyre te sipermendura konsiderohen te kryera definitivisht dhe te kaluara ne pronesi te plote te shoqerise , duke filluar nga momenti i regjistrimit te vet shoqerise ne regjistrin tregtar dhe te depozitimit te ketyre akteve prane gjykates se Tiranes.

Neni 7

Shoqeria do te administrohet nga tre administratore ortake dhe jo ortake. Ata caktohen nga Asambleja e Ortakeve per nje periudhe tre vjecare me te drejte rizgjedhje.

Me kete akt ortaket i japin Z. Skender Leka kompetencat e nevojshme per te kryer formalitetet per krijimin e shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Z. Skender Leka autorizohet te veproje ne emer te shoqerise qe krijohet deri ne regjistrimin e saj prane gjykates.

Ai eshte gjithashtu i pajisur me mandat per te firmosur te gjitha aktet dhe te kontraktot detyrime ne emer te shoqerise, te cilat i kalojne shoqerise nga momenti i regjistrimit te saj.

Neni 8

Sipas legjislacionit shqiptar e ne vecanti te ligjit Nr. 7764, date 2.11.1993 "Per investimet e huaja" aktiviteti i shoqerise dhe investimet e ortakut italian jane te mbrojtura nga shteti shqiptar.

Ortaku italian ka te drejte te transferoj fitimin e vet jashte vendit ne valute te huaj te zgjedhur prej tij.



Neni 9

Ortaku italian merr persiper te reklamoj dhe te gjej treg per prodhimet edhe nepermjet marreveshjeve me shoqeri apo ente te zgjedhura prej tij.

Ortaku shqiptar ve ne dispozicion te gjitha studimet dhe dokumentacionin teknik te nevojshem.

Neni 10

Ortaket jane te detyruar te mbajne sekret dokumentacionin teknik, informacionet te dhenat dhe pervojen e shkembyer te lidhura me raportet mes tyre dhe me ato qe do njihen.

Neni 11

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e marra per qellime te ndryshme nga ato te percaktuara ne kete kontrate dhe statut.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet eventualisht te marra nga ortaket ndaj personave, enteve ose shtetit.

Neni 12

Pagat, oret e punes, pushimet ,etj rregullohen me kontraten kolektive dhe individuale te punes .Per ceshtje te tjera te pa parashikuara ne kontratat e punes zbatohet legjislacioni shqiptar i punes.

Neni 13

Mosmarrevshjet qe mund te lindin mes ortakut te huaj dhe ndermartjeve ose shoqerive shtetere, mes investitorit te huaj dhe administrates shtetere dhe kontradiktat qe lidhen me shpronessimin, diskriminimin dhe transferimin zgjidhen sipas nenit 7 e 8 te ligjit Nr.7764, date 02.11.1993 "Per investimet e huaja" dhe nenit 24 te Statutit.

Neni 14

Kjo kontrate, statuti dhe 7 (shtate) dokumentat bashkelidhur jane hartuar ne shtate kopje origjinale, nga te cilat 5(pese) ne gjuhen shqipe dhe 2(dy) ne italisht duke pasur te njejten vlere.

Nenshkuar ne Tirane, me18.3.1995

PER UP&UP Srl.

PER MINIEREN E MERMERIT MUHUR

ADMINISTRATORI
Baldini Giuseppe

PERFAQESUESI I AUTORIZUAR

Skender Leka

STATUT
I
ITALB MERMERI UP-MUHUR SHPK

Me kapital themeltar 50(pesedhjetë) milion leke
Shoqeri shqiptaro italiane me pergjegjesi te kufizuar per nxjerrje transformim
dhe komercializimin e mermereve dhe gureve dekorativ.



KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

ITALB-MERMERI UP -MUHUR eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar aktiviteti i se ciles rregullohet nga ky statut dhe akti themelues qe eshte pjese perberese e ketij statuti dhe qe i bashkelidhet. Ajo vepron ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe te ligjeve qe do te dalin gjate kohes se veprimtarise se shoqerise.

Akti themelues dhe statuti nuk duhet te kene mospajtime me normativat shqiptare. Per ato qe nuk jane parashikuar ne keto akte do te veprohet sipas legjislacionit shqiptar.

Shoqeria behet person juridik shqiptar nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar.

Neni 2
EMERTIMI

Emertimi i shoqerise eshte, ITALB MERMERI UP-MUHUR Shpk.
Ajo do te kete vulen e saj.

Neni 3
OBJEKTI

A. Nxjerrja, perpunimi, komercializimi dhe eksportimi i mermereve, gureve ornametal, materialeve te ndertimit, te vendit dhe nenprodukteve te tyre.

B. Importimi ne Shqiperi i cdo lloj mermeri, gureve dekorativ dhe nenprodukteve te tyre per perpunim, transformim, tregtim dhe eksportim eventual.

C. Prodhimin, tregtimin, importimin dhe eksportimin e materialeve te ndertimit

D. Zhvillimin e aktiviteteve industriale, tregtare, financiare dhe ndertimi qe do te konsiderohen nga Asambleja e Ortakeve te leverdisshme dhe ne perputhje me objektin e shoqerise.

Neni 4

Parimet e administrimit dhe te zbatimit te aktit themelues dhe te Statutit

Principet, klauzolat, te drejtat e detyrimet qe rezultojne nga akti themelues dhe/ose statuti nuk mund te ndryshohen ose te modifikohen pa vendimin e Asamblese se Ortakeve.

Sipas legjislacionit shqiptar dhe vecanerisht te ligjit nr. 7764, date 02.11.1993

veprimtaria e shoqerise dhe investimet e ortakut italian jane te mbrojtura nga shteti shqiptar. Ortaku italian ka te drejte te transferoj fitimin e vet jashte ne valute te huaj te zgjedhur prej tij.

Ortaket jane te detyruar te mbajne sekret dokumentacionin, informacionin , te dhenat dhe pervojen e shkembyer lidhur me raportet mes tyre ose ato qe do mesojne.

Neni 5

Selia ,filialet,perfaqesite.

Selia e shoqerise eshte vendosur ne Minieren e Mermerit ne Muhur-Peshkopi Shqiperi.

.Asambleja mund ta hap filiale,dege e perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj me shumicen e 3/4 te votave (75%).

Neni 6

Pergjegjesite

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e marra per qellime te ndryshme nga ato te percaktuara ne statut dhe ne aktin themelues.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e marra nga ortaket ndaj personave,enteve ose shtetit.

Neni 7

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte caktuar per 50 (pesedhjete) vjet duke filluar nga data e regjistrimit te saj regjistrin tregtar.

Shoqeria mund te priset para afatit ose te zgjatet koha e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR,KONTRIBUTET,KUOTAT

Neni 8

Kapitali themeltar eshte 50(pesedhjete) milion leke dhe eshte i perbere nga kontributet ne natyre dhe para te ortakeve.

Kontributi i ortakut shqiptar eshte 12.500.000(dymbedhjete milion e peseqind mije) leke i gjithë ne natyre.

Kontributi i ortakut italian eshte 37.500.000(tridhjet e shtate milion e peseqind mije) leke nga te cilat 1.616.000(nje milion e gjashteqind mije) leke ne para.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 5000(pese mije) kuota(pjese) me vlere 10.000(dhjete mije) leke sejcila,te gjitha teresisht te firmosura dhe te shlyera me numer serie nga nje ne pesemije.Sipas kontributeve te sipershenuara ortakut shqiptar i takojne 1250 pjese te kapitalit themeltar,nga numri nje deri te numri 1250 i serise e barabarte me 25 % te kapitalit themeltar.

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



Ortakut italian i takojne 3750 pjese te kapitalit themeltar nga numri 1251 deri ne numrin 5000 te serise e barabarte me 75% te kapitalit themeltar.

A) Kontributet e ortakut shqiptar ne natyre perbehen:

A-1 Nga e drejta e perdorimit per pesedhjetë vjet, vec zgjatjeve apo shkurtimeve te vendburimeve te mermerit dhe gureve dekorativ te minieres se mermerit ne Muhur (MMM) dhe te gjithë territorit perreth qe i takon minieres prej 300.000 m2 sipas planimetrise se aprovuar qe i bashkelidhet. (Lidhje 1)

A-2 Nga pronesia e ngrhinave te ndryshme, e makinerive, impjanteve, pajisjeve, automjeteve ekzistuese ne gjendje pune, mallra ne magazine perfshire dhe blloqe mermeri, te gjitha pronesi e MMM sipas inventarit (Lidhja 3)

B. Kontributet e ortakut italian ne natyre dhe para perbehen:

B-1 Nga kontributi ne para prej 1.616.000 (nje milion e gjashteqind mije) leke te derdhura nga UP&UP Srl ne arken e UPEM-it

B-2 Nga know-how, dokumentacioni teknik, konsulenca teknike e nevojshme per kerkimin dhe shfrytezimin e vendburimeve, transformimin dhe komercializimin e prodhimeve, kontribut qe konvensionalisht dhe definitivisht vleresohen ne 10% (dhjete perqind) te kontributeve ne natyre te UP&UP

B-3 Nga makinerite e nevojshme, pajisjet e materialet per mekanizimin e punes dhe futjen e teknologjive te reja ne shfrytezimin e materialeve. Te gjitha sipas listes bashkelidhur (Lidhja 6)

Te gjitha kontributet ne natyre te ortakut italian te sipertreguara me vlefte prej 35.884.000 jane vleresuar sipas nenit 42 te ligjit 7638, date 19.11.1992 nga nje eksperte i caktuar ne marreveshje midis ortakeve me aktin nr. 7 qe bashkelidhet si pjese perberese e Statutit.

Kontributet ne natyre te ortakut shqiptar jane vleresuar sipas vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 47, date 7.02.1994

Te gjitha kontributet ne natyre te sipermendura konsiderohen te kryera definitivisht dhe te kaluara ne pronesi te plote te shoqerise duke filluar nga data e regjistrimit te vet shoqerise ne regjistrin tregtar dhe depozitimit te ketyre akteve prane gjykates se Tiranes.

Neni 9

Te drejtat dhe detyrat e ortakeve

Cdo pjese (kuote) me vleren e caktuar jep te drejten e nje vote. Ortaket mbulojne humbjet deri ne kufijte e pjesemarrjes tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 10

Regjistrimet ne Librin e Ortakeve ose te kapitalit themeltar

Sejcili ortake regjistron gjithe gjeneralitet e tij, gjendjen shoqerore, vendbanimin ose adresen e punes dhe kuotat e pjesemarrjes tij ne kapitalin themeltar duhet te jene te regjistruar ne Librin e Ortakeve ose te kapitalit themeltar. Ne te duhet te regjistrohen dhe kuotat me te larta ose te ulta te pjesemarrjes per rritjen ose zvogelimin e kapitalit themeltar si dhe blerjet ose shitjet e kuotave te pjesemarrjes ne kuotat e reja relative te



pjesemarrjes se ortakut.Me kerkesen e ortakut,shoqeria i leshon nje certifikate te regjistrimit te tij ne Librin e Ortakeve dhe kuotat e pjesemarrjes.

Neni 11 Rritja e kapitalit

Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne cdo kohe ne nje ose disa here me votim ne asamblene e jashtezakonshme te ortakeve kur jane te pranishem ose te perfaqesuar ortakët qe kane te pakten 3/4 e kapitalit themeltar.Kur vendoset rritja e kapitalit te gjithë ortakët kane te drejte te nenshkruajne rritjen ne proporcion me kuotat e kapitalit qe disponojne.Ne rast se nuk duan ta ushtrojne kete te drejte kuotat e tyre mund te nenshkruhen nga ortakët e tjere proporcionalisht me pjesemarrjen e tyre.

Vleresimet e kontributeve te ortakeve behen ne leke dhe valute te huaj sipas kursit te kembimit te Bankes shtetereore shqiptare ne ditën kur kryhet derdhja.

Menyrat dhe afatet e derdhjes se kontributeve te kapitalit themeltar ne natyre ose para vendosen nga asambleja e ortakeve.Kontributet ne natyre do te vleresohen sipas kerkesave te ligjit.Ortaku qe nuk derdh kontributet sipas afateve te caktuara duhet ti paguaj shoqerise nje interes prej 0.5%(zero pese perqind) mbi kuotat e pa derdhura vec rasteve te justifikuara dhe te njohura nga ortakët.

Kontributet e ortakut italian do te derdhen teresisht tre muaj pas regjistrimit ne gjykate mbas ketij afati vec zbatimit te penaliteteve ortakeve u lind e drejta per te kerkuar rregullimin e detyruar ose pridhjen e kontrates.

Neni 12 Zvogelimi i kapitalit

Me vendim te asamblese se jashtezakonshme shoqeria mund te ule kapitalin themeltar kur votat e ortakeve qe votojne te pranishem ose te perfaqesuar arrijne te pakten 3/4 e kapitalit themeltar.

Ulja e kapitalit perballohet nga sejcili ortakë ne proporcion me kuotat qe disponon.

Neni 13 Transferimi i kuotave

Kuotat mund tu transferohen te treteve teresisht ose pjeserisht vetem me aprovimin ne asamblene e jashtezakonshme me shumicen e ortakeve qe perfaqesojne te pakten 3/4 te kapitalit themeltar.Ne cdo rast kuotat duhet t'ju ofrohen ortakeve ; vetem ne rast se refuzohen nga keta,mund tu jepen te treteve me kusht qe transferimi te mos behet ne kushte me te favorshme se ato qe u jane propozuar ortakeve.

KREU III ASAMBLEJA;ADMINISTRATORET;KONTROLLI

Neni 14

Asambleja e Ortakeve dhe kompetencat

Organi vendimor i shoqerise eshte asambleja e ortakeve.Vendimet me shumicen

e saj janë të detyrueshme për ortakët që mungojnë ose që janë kundër, duke njohur të drejtën e tyre për kundërshtim në rastet, kohën dhe formën e parashikuar nga ligji.



Neni 15

Te drejtat e pjesëmarrjes dhe votimit

Cdo ortakë ka të drejtë të marrë pjesë në asamblë, të shpreh mendimin e vetë dhe të shprehë qëndrimin sa janë kuotat e tij në kapitalin themeltar të derdhur.

Cdo ortakë ka të drejtë të përfaqësohet e të shprehë votat e tij nga një subjekt i deleguar prej tij me akt të shkruar.

Një ortakë nuk mund të japë prokurë votimi për një pjesë të kapitalit të tij në qoftë se voton për pjesën e mbetur.

Neni 16

Mbledhja e asamblese

Asambleja e zakonshme duhet të mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 muajesh nga mbyllja e vitit financiar, për aprovimin e bilancit, raportet e administratorëve dhe ekspertit kontabel si dhe të inventarit.

Ajo mund të thirret në çdo kohë nga presidenti i administratorëve, nga njëri prej administratorëve, nga eksperti kontabel ose nga likuidatori, kur e shikojnë të nevojshme si dhe nga një ose më shumë ortakë që përfaqësojnë më së shumti 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar.

Asambleja thirret me leter rekomande që ju dërgohet ortakëve në adresën e shtepisë të shënuar në Librin e Ortakëve dhe nga eksperti kontabel (po të jetë emëruar) të paktën 30 ditë përpara. Ajo duhet të cilesojë tipin e asamblese, materialin që do të diskutohet dhe vendoset, vendin, orën, dhe ditën e mbledhjes së parë dhe të dytë të asamblese.

Asambleja konsiderohet e mbledhur rregullisht edhe duke mos respektuar këto formalitete në qoftë se marrin pjesë ose janë të përfaqësuar të gjithë ortakët, gjithë administratorët dhe ekspertit kontabel.

Sipas rëndësise së vendimeve, asambleja mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

Asambleja e zakonshme vendos për të gjitha çështjet që nuk i paraqiten asamblese së jashtëzakonshme, të parashikuara nga statuti ose ligji, veç emërimit ose shkarkimit të administratorëve dhe ekspertit kontabel, aprovon bilancet, raportet e administratorëve dhe të ekspertit kontabel (kur ka) dhe inventarin, shpërndan fitimin autorizon transferimin e tyre të tretëve, etj.

Aprovon planet e shitjes, organizimit dhe zhvillimit të aktivitetit dhe bilancit preventiv.

Asambleja e jashtëzakonshme mbahet në prani të noterit për mbajtjen e proces verbalit dhe vendos për ndryshimet në kontratë dhe statut për hapjen e filialeve, degeve e përfaqësive jashtë, rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar, hapjen e aktiviteteve të tjera dhe pjesëmarrjen, transferimit e kuotave të kapitalit themeltar të tretëve, zgjatjen e afatit të veprimtarisë së shoqërisë, likuidimin, ndryshimin e llojit të shoqërisë, emërimin dhe revokimin e likuidatorëve.

Asambleja kryesohet nga presidenti i administratoreve ose nga nje ortake tjeter i cakruar nga asambleja. Per mbajtjen e procesverbaleve asambleja emerone nje sekretar edhe nje ortake.

Asambleja e zakonshme konsiderohet e mbledhur rregullisht dhe mund te marre vendime ne qofte se jane prezent ose te perfqesuar mbi 50 % (pesedhjete) perqind te kapitalit themeltar dhe vendimet merren me te njejten shumice te votave te shprehura nga ortaket votues te pranishem ose te perfaqesuar.

Ne qofte se mungon numri i nevojshem, asambleja duhet te mblidhet ne thirrjen e dyte. Kjo mund te mbahet dhe te vendos me shumicen sado qe te jete numri i ortakeve te pranishem te perfaqesuar ose votues; vec rasteve kur emerohen ose shkarkohen administratoret. Ne keto raste te pranishmit dhe votat e shprehura nga ortaket votues te pranishem ose te perfaqesuar duhet te jene mbi 50 % (pesedhjete perqind) te kapitalit themeltar edhe ne thirrjen e dyte.

Asambleja e jashtezakonshme konsiderohet e mbledhur rregullisht dhe merr vendime ne thirrjen e pare dhe te dyte kur jane prezent te pakten 3/4 (tre te katertat) e zoteruesve te kapitalit themeltar dhe me vota ne favor, te ortakeve prezent ose te perfaqesuar si, ne thirrjen e pare dhe te dyte e te pakten 3/4 (tre te katertat) e kapitalit themeltar.

Vendimet e asamblese duhet te verbalizohen dhe te firmosen nga presidenti dhe nga sekretari ose noteri.

Me kerkesen e ortakeve ne proces verbal duhet te pasqyrohen te permbledhura edhe diskutimet e tyre.

Neni 17 Administrimi

Shoqeria administrohet nga tre administratore ortake dhe jo ortake qe emerohen ose shkarkohen edhe vec e vec nga asambleja e zakonshme, me miratimin e ortakeve votues te pranishem apo te perfaqesuar qe edhe ne thirrjen e dyte perfaqesojne mbi 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit themeltar.

Ata zgjidhen per nje periudhe prej tre vjetesh dhe mund te rizgjidhen.

Administratoret me shumice emerone nje president.


Presidenti kryen perfaqesimin aktiv dhe pasiv te shoqerise ndaj te treteve dhe eshte organ ekzekutiv i vendimeve te administratoreve te marra, pa perjashtim me shumice; vec kompetencave qe i takojne sipas statutit ose ligjit asamblese se ortakeve.

Administratoret kane te gjitha kompetencat e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem sipas objektivave te shoqerise.

Administratoret jane pergjegjes ose ndaj te treteve per veprimet dempruese, shkeljet e ligjit ose statutit dhe per gabime te renda te administrimit.

Neni 18 Marreveshjet

Raportet mes shoqerise dhe ortakeve te vecante, administratoreve e punonjesve te vet shoqerise, per mundesine e berjes se kontratave ose marreveshjeve mes tyre dhe shoqerise rregullohen sipas vendimit Nr.93, date 28.02.1994





Neni 19

Transferimi i kompetencave

Administratoret me shumice votash mund ti kalojne nje pjese te kompetencave drejtoriale ne do te jete me kombesi shqiptare me akt noterial i cili duhet te permbaje ne menyre te sakte dhe taksative kompetencat e dhena.

Neni 20

Eksperti kontabel

Kontrolli shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar,i emeruar nga asambleja me shumicen e ortakeve qe perfaqesojne edhe ne thirrjen e dyte mbi 50% (pesedhete perqind) te kapitalit themeltar.Ai emerohet per gjashte vjet dhe mund te riemerohet.

Eksperti kontabel mund te shakarkohet me te njejten procedur te emerimit ne qofte se rezultojne gabime,neglizhenca,ose zvarritje ne kryerjen e detyrave te tij.

KREU IV

VITI FINANCIAR;BILANCET;NDARJA E FITIMIT

Neni 21

Bilancet dhe relacionet

Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor .Bilancet vjetore,inventari,raportet e administratoreve dhe ekspertit kontabel te autorizuar duhet te aprovohen nga asambleja e zakonshme e ortakeve,brenda 6 muajeve nga mbarimi i vitit financiar me miratim te ortakeve qe perfaqesojne te pakten 50% (pesedhete perqind) te kapitalit themeltar.

Te gjitha keto dokumenta duhet tu njoftohen ortakeve dhe te vihen ne dispozicion te tyre prane selise se shoqerise te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese;ata kane te drejte te paraqesin pyetje me shkrim ,te cilave administratoret jane te detyruar ti pergjigjen gjate asamblese.

Ortaku ka te drejte te kerkoje dhe te marre ne cdo kohe,dokumentat relative te tre vjeteve te fundit fiskale dhe ne diskutim para asamblese mund te asistohet nga nje ekspert i besuar dhe i angazhuar te ruaj sekretin profesional.

Neni 22

Fitimet,fondi rezerve

Mbas aprovimit te bilanceve asambleja e ortakeve percakton fitimet qe do te shperndahen,duke zbritur me pare humbjet e viteve paraardhese dhe fondin rezerve prej 5% te fitimit per vitin e pare e ne vazhdim deri sa shuma e tij te arrij vleren e 1/10 te kapitalit themeltar.

Asambleja mund te caktoj dhe zbritje te vecanta te fitimit ne favore te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera.

KREU V
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE
Neni 23

Shoqeria priset me mbarimin e afatit te caktuar,pervec rasteve kur behet zgjatja e tij.

Ajo priset para mbarimit te afatit me vendim te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve ose ne rastet e parashikuara nga ligji.

Shoqeria nuk priset ne rastet e paafetise, vdekjes ose falementimit te ortakeve.

Kur shoqeria priset para afatit me vendim te asamblese ose sipas ligjit, ajo hyn ne likuidim. Per kete asambleja e jashtezakonshme emeron nje a me shume likuidatore qe jane te detyruar te paraqesin nje relacion mbi gjendjen e administrimit te pasurive te shoqerise, per veprimet e likuidimit te planifikuar dhe kohen e nevojshme per ta kryer.

Ne mbarim te likuidimit ,asambleja e jashtezakonshme prononcohet per realcionin e likuidatoreve, per bilancin perfundimtar te likuidimit dhe per mbylljen e aktivitetit ,me shumicen e votave qe perfaqesojne te pakten 3/4 e kapitalit themeltar.

Mbas pagimit te kreditoreve, likuidatori u shperndan ortakeve kapitalin e mbetur, proporcionalisht me kuotat respektive ne kapitalin themeltar.

Filialet likuidohen me te njejtat modalitete.

Fitimet dhe pronat e mbetura te degeve dhe perfaqesive ndahen ne mes ortakeve proporcionalisht me kuotat e tyre ne kapitalin themeletar.

KREU VI
Neni 24

Gjithe mosmarreveshjet qe mund te lindin mbi vlefshmerine, interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e kontrates dhe te ketij statuti dhe ato qe lindin mes ortakeve (vec atyre per marredhenie personale ose parasociale) ose mes ortakeve dhe shoqerise dhe qe nuk arrihet te zgjidhen miqesisht, i referohen Kolegjit te Arbitrave te Dhomes se Tregtise ne Paris.

Neni 25


Ky statut u hartua ne 7(shtate) kopje nga te cilat pese ne shqip dhe dy ne italisht duke pasur te njejten vlere.

Tirane, me....

ORTAKET

PER UP&UP SRL
ADMINISTRATORI

BALDINI GIUSEPPE



PER MINIEREN E MERMERIT MUHUR
PERFAQESUESI I AUTORIZUAR

SKENDER LEKA

